

RAPORTI I TAKIMIT VJETOR TË KUVENDIT TË ANËTARËVE

Data dhe vendi	11 Korrik 2015, Prizren (zyra e EC Ma Ndryshe)
Pjesëmarrësit	<i>Anëtarët:</i> Taulant Gutaj, Arnet Haskuka, Ajtene Krasnqi, Kreshnik Basha, Dren Marseli, Enver Batiu, Edon Mullafetahu, Flaka Siqeca, Besart Lumi, Enesa Xheladini, Antigona Shestan, Ernesta Jadrashi <i>Stafi i organizatës:</i> Hajrulla Çeku (drejtor ekzekutiv), Admir Istrefi (koordinator i financave), Valon Xhabali (koordinator programi)
Agjenda e takimit	Hapje e takimit dhe mirëseardhje <i>Miratimi i rendit të ditës</i> Prezantimi i raporteve Janar – Qershor 2015, diskutim dhe miratimi i tyre Prezantim i Planit për pjesën e mbetur të 2015, diskutim dhe miratim Diskutime për identitetin vizual të organizatës (llogo dhe të tjera) Çështje operationale të organizatës Mbyllja e takimit

Hapje e takimit

Takimi u hap nga Kreshnik Basha, Kryesues i Kuvendit të Anëtarëve për vitin 2015. Rendi i ditës u miratua pa ndryshim.

Prezantimi i raporteve Janar – Qershor 2015, diskutim dhe miratimi i tyre

Rapori i punës për gjysmën e parë të vitit 2015 u prezantua nga drejtori ekzekutiv i organizatës. Ky raport përfshin: projektet e realizuara gjatë gjashtë muajve të parë të vitit, iniciativat dhe aktivitetet e tjera, publikimet, partneritetet dhe të arriturat e punës gjashtë mujore. Pas raportit gjashtë mujor të punës, koordinatori i financave i organizatës e prezantoi raportin gjashtë mujor financiar. Ky raport përfshin: listën e projekteve dhe donatorëve bashkë me shumën e përkrahjes, të hyrat gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2015 në bazë të projekteve/donatorëve (116,920.34 EUR), shpenzimet detaje gjatë kësaj periudhe (126,572.36 EUR) dhe gjendjen aktuale në xhirollogarinë e organizatës në fund të periudhës raportuese (20,631.14 EUR).

Prezantimi i raportit të punës dhe atij financiar për gjashtë muajt e parë të vitit 2015 u pasua me diskutim të anëtarëve të Kuvendit. Pas diskutimeve rreth të dy raporteve, anëtarët e Kuvendit votuan veç e veç për secilin prej këtyre raporteve. Me votat PËR të të gjithë anëtarëve prezent, në votime të veçanta, u miratuan Raporti i Punës Janar-Qershor 2015 dhe Raporti Financiar Janar-Qershor 2015. Të

dyja dokumentet (raportet), në formën e tyre përfundimtare të miratuara nga Kuvendi i Anëtarëve do të publikohen në web-faqen e organizatës.

Prezantim i Planit për pjesën e mbetur të 2015, diskutim dhe miratim

Planet për gjysmën e dytë të vitit 2015 u prezantuan nga drejtori ekzekutiv i organizatës. Dokumenti bazë për pjesën e dytë të vitit është Plani i Punës 2015, i miratuar në takimin e kaluar të Kuvendit të Anëtarëve. Në këtë pikë, u diskutua edhe për Strategjinë 2015-2019 të organizatës, për të siguruar që aktivitetet dhe planet vjetore janë në përputhje me objektivat strategjik afatgjatë të organizatës. Dokumenti i zhvillimit strategjik të EC Ma Ndryshe për vitet 2015-2019 u hartua gjatë pjesës së dytë të vitit 2014, me ndihmën edhe të dy konsulentëve të jashtëm. Sipas orientimit të ri strategjik, EC ka filluar të zbatojë orientim të tërësishëm komunitar. Ky dokument i ridefinon misionin, vizionin dhe vlerat e EC-it, duke reflektuar në punën e viteve të fundit dhe orientimet strategjike për vitet në vijim.

Pas prezantimit të planeve për gjysmën e dytë të vitit 2015, u diskutuan detaje të caktuara për zbatimin e Planit të Punës për vitin 2015. Anëtarët u pajtuan që Plani i Punës 2015 të mos pësojë ndryshime dhe organizata të vazhdojë me aktivitete të parapara në këtë plan deri në fund të vitit.

Diskutime për identitetin vizual të organizatës (llogo dhe të tjera)

Anëtarët e trajtuan edhe propozimin e menaxhmentit për ndryshimin e identitetit vizual të organizatës. Ndonëse kishte mendime të ndryshme rreth nevojës për ndryshime, në fund u propozua krijimi i një grupi punues të brendshëm (anëtarë dhe staf) për të përgaditur një propozim rreth identitetit të ri vizues të organizatës. Ky propozim do të shpaloset dhe diskutohet në takimin e rradhës të Kuvendit të Anëtarëve (takimi i dytë i vitit 2015). Identiteti i ri vizues i organizatës, sipas këtij propozimi duhet të ndërtohet rreth llogos së re, nga e cila duhet të derivojnë edhe produktet tjera.

Çështje operacionale dhe Diskutime dhe vendime të tjera

- Organizata të angazhohet edhe për dërgimin e rasteve të shkeljeve (nga autoritetet publike) në institucionet e gjyqësisë, duke e shtuar edhe “strategic litigation” në metodat e punës dhe avokimit,
- Deri në fund të vitit, të realizohet një rast konkret i padisë ndaj autoriteteve publike për shkelje të identifikuar gjatë punës së organizatës,
- Artefakte të rëndësishme të trashëgimisë kulturore të Prizrenit, të cila gjenden në vendet tjera (edhe jashtë Kosovës) duhet t’i kthehen qytetit. Organizata të hulumtojë mundësitë për të realizuar këtë synim,
- Të analizohen mundësitë që Prizreni të ketë panairin e vet të produkteve turistike, si mundësi për promovimin e vlerave dhe potencialeve të qytetit,
- Organizata të jetë më këmbëngulëse në luftimin e degradimit dhe zaptimit të hapësirës publike të qytetit.